



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 maj 2024
Nr. ref.: AGJ 2428/24

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI121/22

Parashtrues

Mexhid Asllani, Ekrem Asllani dhe Nuredin Xhaferi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit [Rev. nr. 434/2022] të 24 majit 2022 për plotësimin e
Aktgjykimit [Rev. nr. 426/2021] të 29 qershorit 2021 të Gjykatës Supreme
dhe
Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Mexhid Asllani, Ekrem Asllani dhe Nuredin Xhaferi, të gjithë nga fshati Komogllavë, komuna e Ferizajt (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës), të përfaqësuar nga Arbër Istrefi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Rev. nr. 434/2022] të 24 majit 2022 për plotësimin e Aktgjykimit [Rev. nr. 426/2021] të 29 qershorit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) dhe kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit, në ndërlidhje me Aktgjykimin [C. nr. 395/2015] e 23 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të lartcekura, me të cilat parashtruesit e kërkesës pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur, e cila ka shfuqizuar Rregulloren e punës Nr. 01/2018 të Gjykatës. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 4 gusht 2022, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
7. Më 8 gusht 2022, Kryetarja e Gjykatës, me vendimin GJR. KI121/22, caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi, gjyqtar raportues dhe me vendimin KSH. KI121/22 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 15 gusht 2022, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesve të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
9. Më 6 dhjetor 2022, Gjykata Themelore në Prizren njoftoi Gjykatën se aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 15 shkurt 2022.

10. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
11. Më 26 korrik 2023, Gjykata kërkoi informata shtesë nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore në Ferizaj, në lidhje me ankesën e parashtruar më 31 korrik 2017 nga parashtruesit e kërkesës në Gjykatën e Apelit.
12. Më 28 korrik 2023, Gjykata e Apelit e informoi Gjykatën se në shkresat e lëndës të cilat mbesin në këtë gjykatë nuk ka pasur ankesa tjera, dhe se *"Për informata shtesë nëse ka pasur ankesa të tjera i drejtohem Gjykatës Themelore në Ferizaj, për shkresat e lëndës C.nr.395/2015"*.
13. Më 3 gusht 2023, Gjykata Themelore e informoi Gjykatën: *"... se mjeti juridik-ankesa e palëve paditëse Mexhid Asllani, Ekrem Asllani dhe Nuredin Xhaferi është dorëzuar dhe protokolluar në Gjykatën Themelore-Ferizaj, më datë 5 shtator 2017"*.
14. Më 8 shtator 2023, Gjykata sërish kërkoi informata shtesë nga Gjykata Themelore, për të kuptuar nëse kjo e fundit e kishte proceduar ankesën e parashtruesve të kërkesës në Gjykatën e Apelit për shqyrtim dhe vendimmarrje.
15. Më 25 shtator 2023, Gjykata Themelore e informoi Gjykatën se, ankesat e parashtruara nga parashtruesit e kërkesës dhe nga Sigal Uniqua Group Austira (e padituara), kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore janë protokolluar në Gjykatën Themelore më 5 shtator 2017 dhe pasi që është kompletuar lënda, të njëjtat janë dorëzuar në Gjykatën e Apelit, për procedim të mëtutjeshëm.
16. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
17. Më 21 mars 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta deklarojë kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita. Të njëjtën ditë, Gjykata në përbërje të plotë pas këshillimit, me pesë (5) vota "për" dhe katër (4) "kundër" konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së. Në këtë rast, gjyqtari Jeton Bytyqi deklaroi se në lidhje me konstatimet e shumicës do të paraqes mendim mospajtues, të cilit i është bashkuar dhe gjyqtari Enver Peci.

Përmbledhja e fakteve

18. Kërkesa ka të bëjë me një kontest civil ndërmjet parashtruesve të kërkesës dhe kompanisë së sigurimeve Sigal Uniqua Group Austria, me seli në Prishtinë, në lidhje me një aksident komunikacioni që kishte ndodhur në magjistralen Ferizaj - Kaçanik, nga i cili parashtruesit e kërkesës pësuan lëndime. Në këtë rast, për shkaktimin e aksidentit ishte gjetur fajtor i siguruari i kompanisë Sigal Uniqua Group Austria. Pas kësaj ngjarjeje parashtruesit e kërkesës kanë ndjekur procedurat, si më poshtë.
19. Më 15 korrik 2015, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesëpadi në Gjykatën Themelore, duke kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jomaterial të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit në aksin rrugor Ferizaj – Kaçanik. Parashtruesi i kërkesës M. Asllani në emër të dëmit kishte kërkuar 5389,00 euro, E. Asllani, shumën prej 5768.00 euro dhe N. Xhaferi shumën prej 5434,00, euro.
20. Më 7 qershor 2017, parashtruesit e kërkesës e precizuan padinë e tyre.

21. Më 23 qershor 2017, Gjykata Themelore, duke vendosur sipas kërkesëpadisë së parashtruesve të kërkesës, nxori Aktgjykimin C. nr. 395/2015, nëpërmjet të cilit:

I. Aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës;

II. Detyroi të paditurën Sigal Uniqua Group Austria, që në emër të dëmit jomaterial dhe material t'i paguaj:

- i. parashtruesit të kërkesës Mexhid Asllani: a) për dhimbje trupore - fizike shumë prej 1200,00 euro, b) për frikë të pësuar shumë prej 950,00 euro, dhe c) në emër të dëmit material shpenzimet e mjekimit në shumë prej 809,00 euro. Gjithsej nga shuma 5389,00 euro: 2959 të aprovuara dhe 2430,00 të refuzuara;
- ii. parashtruesit të kërkesës Ekrem Asllani: a) për dhimbje trupore - fizike shumë prej 1400,00 euro, b) për frikë të pësuar shumë prej 1050,00 euro, dhe c) në emër të dëmit material shpenzimet e mjekimit në shumë prej 668,00 euro. Gjithsej nga shuma 5768,00 euro: 3118,00 të aprovuara dhe 2650,00 të refuzuara; dhe
- iii. parashtruesit të kërkesës Nuredin Xhaferi: a) për dhimbje trupore-fizike shumë prej 1700,00 euro, b) për frikë të pësuar shumë prej 1000,00 euro, c) për ndihmë nga personi tjetër shumë prej 30,00 euro, dhe d) për ushqim të përforcuar shumë prej 30,00 euro. Gjithsej nga shuma 5434,00 euro: 2674,00 të aprovuara dhe 2760,00 të refuzuara.

III. Detyroi të paditurën që parashtruesve të kërkesës t'ua paguaj shumat e caktuara sikurse në pikën II të dispozitivit, e në shumë e përgjithshme prej 8751.00 euro, kamatën ligjore në lartësinë prej 8% (tetë përqind), nga 15 korriku 2015, deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 1618,00 euro, të gjitha në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmëria e vendimit. Marrë në përgjithësi vlera e përgjithshme e refuzuar nga kjo gjykatë është gjithsej 7,840.00 euro.

22. Gjykata Themelore, ndër të tjera, theksoi se në rrethanat e rastit konkret nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por lartësia e saj, sepse ishte vërtetuar se i siguruari i të paditurës ishte fajtor për shkaktimin e aksidentit në komunikacion. Për më tepër, në arsyetim theksohet: *“Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit jomaterial dhe material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së, dhe në kuptim të dispozitave të neneve 136, 159, 169, 174, 182, dhe 961 të LMD-së, duke u bazuar në mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. B.I, ortoped - traumatolog dhe Dr. M.A, neuropsikiatër, të cilëve gjykata ia ka falur besimin në tërësi, mendimin e tyre e kanë dhënë në procesverbalin e dt.17.05.2017 dhe në seancën e dt.31.05.2017, si dhe dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës të cilat janë të administruara si prova në këtë çështje juridike”.*

23. Më 4 korrik 2017, e paditura Sigal Uniqua Group Austria parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, ndaj Aktgjykimit të 23 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore, për shkak të pretendimeve për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave të procedurës dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

24. Më 31 gusht 2017, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit, ndaj Aktgjykimit të 23 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore për shkak të mospajtitimit me lartësinë e kompensimit (dëmshpërblimit), duke kërkuar aprovimin e kërkesëpadisë në tërësi. Në ankesën e tyre parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, potencuan:

“Theksojmë edhe njëherë faktin se paditësit megjithëse sipas ekspertizës mjekësore kanë pësuar lëndime të lehta trupore, ekspertët por edhe provat vërtetojnë se këto lëndime janë të shumta dhe si të tilla paraqitet ende nevoja për rehabilitim në të ardhmen meqenëse paditësit shpeshherë janë udhëzuar të vizitojnë tretmane fizioterapeutike dhe prandaj edhe shpenzimet e shërimit janë të larta, porse shuma e gjykuar nuk paraqet satisfacion e merituar për të gjitha këto lëndime të pësuar”.

25. Më 4 mars 2020, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin Ac. nr. 1148/2018, duke vendosur vetëm përkitazi me ankesën e të paditurës Sigal Uniqua Group Austria. Nëpërmjet këtij aktgjykimi, gjykata në fjalë: (i) refuzoi ankesën e të paditurës, dhe (ii) konfirmoi Aktgjykimin [C. nr. 395/2015] e 23 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore, me arsyetimin se: *“... pretendimet ankimore të palës së paditur lidhur me atë se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, janë të pathemelta dhe vlerëson se gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka marrë aktgjykimin i cili sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe për faktet vendimtare, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet adekuate për një vendosje të këtillë, bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështjeje kontestuese”.*
26. Më 29 qershor 2020, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme ndaj Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material, përfshirë këtu edhe shkeljen e të drejtës për ankesë, si rezultat i mosshqyrtimit të ankesës së tyre të parashtruar më 31 gusht 2017 nga Gjykata e Apelit, duke theksuar se me: *“Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1148/2018 të datës 04.03.2020, është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr. 395/15, duke e refuzuar ankesën e të paditurës, ndërsa sa i përket ankesës së paditësve Gjykata e Apelit nuk ka vendosur fare”.*
27. Kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, brenda afatit ligjor kishte parashtruar edhe e paditura Sigal Uniqua Group Austria, ndaj Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material.
28. Më 29 qershor 2021, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. nr. 426/2021, (i) refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të ushtruar nga e paditura Sigal Uniqua Group Austria, duke lënë në fuqi Aktgjykimin [Ac. nr. 1148/2018] e 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit, me arsyetimin se: *“Në revizionin e paraqitur nga pala e paditur, nuk ka pasur pretendime sa i përket shkeljeve thelbësore të procedurës, por vetëm sa i përket aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, pa theksuar se cilat dispozita ligjore janë shkelur nga gjykatat e instancave më të ulëta, por vetëm duke u kufizuar në pretendimin sa i përket shumave të gjykuara, pa arsyetuar pse të njëjtat shuma janë të larta”. [...]. Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, kur aktgjykimi është bazuar në dispozitat e nenit 183, dhe 961, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), duke e detyruar të paditurën, që paditësve t’ua kompensoj shumat e gjykuara, si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë”.*
29. Më 2 gusht 2021, parashtruesit e kërkesës, pasi pranuan Aktgjykimin [Rev. nr. 426/2021] e 29 qershorit 2021 të Gjykatës Supreme, pranë kësaj të fundit, parashtruan kërkesë për shqyrtimin e kërkesës së tyre për revizion, me pretendimin se kërkesa e tyre për revizion, e ushtruar në Gjykatën Supreme më 29 qershor 2020, nuk ishte shqyrtuar fare nga kjo e fundit. Në kërkesën për shqyrtim të revizionit, parashtruesit e kërkesës, theksuan: *“... me datën 31.08.2017 kemi ushtruar edhe ankesë në Gjykatën e Apelit për*

të cilën Gjykata e Apelit të Kosovës nuk e ka shqyrtuar ankesën tonë, andaj kopjen e ankesës dhe revizionit po e bashkëngjisim me parashtruesë, megjithëse origjinali është në shkresat e lëndës, propozojmë që lënda të ekspedohet edhe njëherë në Gjykatën Supreme të Kosovës, për t'u vendosur përkritazi me revizionin e paditësve të dorëzuar në afat ligjor, e për të cilin Gjykata Supreme nuk është deklaruar në Aktgjykimin e saj të datës 29.06.2021”.

30. Më 24 maj 2022, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin [Rev. nr. 434/2021] për plotësimin e Aktgjykimit të saj [Rev. nr. 426/2021] të 29 qershorit 2021. Nëpërmjet këtij aktvendimi plotësues e njëjta e hodhi poshtë, si të palejuar, kërkesën për revizion të parashtruesve të kërkesës, me arsyetimin vijues: “Gjykata Supreme duke e marrë parasysh dispozitën e nenit 211.2 të LPK-së, ku parashihet që në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 €. [...] Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të lejueshmërisë së revizionit sipas nenit 211.2 dhe 221, të LPK-së, ka gjetur se: Revizioni i të autorizuarit të paditësve është i palejuar”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesit e kërkesës në Gjykatë pretendojnë se Aktvendimi plotësues [Rev. nr. 434/2022] i 24 majit 2022, në ndërlidhje me Aktgjykimin [Rev. nr. 426/2021] e 29 qershorit 2021 të Gjykatës Supreme, dhe Aktgjykimi [Ac. nr. 1148/2018] i 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit shkelin të drejtat e tyre të garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), si dhe me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

i. Pretendimet në lidhje me shkeljen e të drejtës për “gjykim të drejtë”

32. Parashtruesit e kërkesës fillimisht theksojnë se Gjykata e Apelit nuk e kishte trajtuar fare ankesën e tyre të ushtruar kundër Aktgjykimit [C. nr. 395/15] të 23 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore, i cili sipas tyre nuk akordoi shpërblim të drejtë, që do t'u shërbente atyre “si satisfakcion i merituar material për këtë të keqe që iu është shkaktuar, e pikërisht për këto shkaqe është ushtruar ankesa në Gjykatën e shkallës së dytë, por që e njëjta nuk është shqyrtuar fare nga kjo gjykatë. Andaj, në rastin konkret kemi të bëjmë me një gjykim jo të drejtë, e në të mirë të palës së paditur- kundërshtare, e në rastin konkret është shkelur edhe parimi i barabarësisë së palëve, pasi që Gjykata e shkallës së dytë nuk ka qenë objektive kur ka vendosur vetëm për ankesën e të paditurës, ndërsa ankesën e palës paditëse nuk e ka shqyrtuar fare, duke rënë kështu në kundërshtim me dispozitat e cekura më lart, duke ua shkelur palëve paditëse të drejtat e garantuara me Kushtetutë të Republikës së Kosovës”.
33. Mbi këtë bazë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se “qëndrimi i Gjykatës së Apelit nuk mund të pranohet dhe nuk mund të qëndrojë, duke pasur parasysh faktin se e drejta për mjete juridike dhe shqyrtim të tyre është e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në rastin konkret parashtruesve të kërkesës iu është mohuar kjo e drejtë fillimisht nga Gjykata e Apelit, për më tepër në arsyetim të këtij vendimi nuk është cekur fare se palët paditëse kanë parashtruar ankesë”.
34. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se edhe Gjykata Supreme, duke hedhur poshtë si të palejuar kërkesën e tyre për revizion, me Aktvendimin [Rev. nr. 434/2022] të 24 majit 2022, për plotësimin e Aktgjykimit [Rev. nr. 426/2021] të 29 qershorit 2021 ua mohoi atyre të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Në këtë kontekst,

parashtruesit e kërkesës theksojnë: “... në rastin konkret të dy gjykatat, me aktgjykimet e tyre, duke shqyrtuar vetëm ankesën e të paditurës e jo edhe ankesën e paditësve kanë shkaktuar mosrespektimin e parimit të barabarësisë së mjeteve nga palët në procedurë, në rastin konkret parashtruesve të kërkesës iu janë shkelur të drejtat dhe liritë individuale të garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëria), respektivisht neni 31 - [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6 - [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - KEDNj, neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragrafët 3 dhe 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

35. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenin 6 të KEDNj-së, shkelje të nenit 32 dhe 54 të Kushtetutës; (iii) të shpallet i pavlefshëm Aktgjykimi [Ac. nr. 1148/18] i 4 marsit 2020 i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi [Rev. nr. 434/2021] i 24 majit 2022 për plotësimin e Aktgjykimit [Rev. nr. 426/2021] të 29 qershorit 2021 të Gjykatës Supreme; duke e kthyer lëndën pranë Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me ankesën e tyre të 31 gushtit 2017, ose në Gjykatën Supreme për të vendosur për meritat e çështjes dhe aprovimin e tërësishëm të kërkesëpadisë lidhur me shumat e kërkuara si dëmshpërblim, për shkak të lëndimeve të pësuar nga aksidenti.

Dispozitat relevante kushtetuese

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Nenin 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.

Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”.

[...]

LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 32

32.1 Në qoftë se një padi e ngritur kundër një të padituri përfshihen disa kërkesa që mbështetën në të njëjtën bazë faktike dhe juridike, atëherë vlera e objektit të kontestit caktohet sipas shumës së përgjithshme të vlerës së të gjitha kërkesave.

32.2 Në qoftë se kërkesat në padi rezultojnë nga baza të ndryshme, apo në qoftë se janë ngritur kundër disa të paditurve, vlera e objektit të kontestit caktohet sipas vlerës së secilës kërkesë veç e veç.

Aktgjykimi plotësues

Neni 162

162.1 Po që se gjykata nuk ka vendosur mbi të gjitha kërkesat që është dashur të përfshihen me aktgjykim, ose kur vetëm një pjesë e kërkesës ka mbetur pa u përfshirë me të, pala mundet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur i është dorëzuar aktgjykimi t'i propozojë gjykatës që të bëjë plotësimin e tij.

MJETET E ZAKONSHME TË GODITJES

ANKESA KUNDËR AKTGJYKIMIT

Shkaqet nga të cilat mund të goditet Aktgjykimi

Neni 181

181.1 Aktgjykimi mund të goditet:

a) për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore;

MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES REVIZIONI

Neni 211

211.1 Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi.

211.2 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 euro.

[...]

Neni 218

1. Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hudhet poshtë me aktvendim të Gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore.

2. Revizioni është i palejueshëm nëse:

- a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit;
- b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin

- c) nëse personi i cili ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij;
d) është paraqitur revizioni kundër aktgjyqimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet.

Neni 221

Revizionin e vonuar, jo të plotë dhe të palejueshëm me, aktvendim e hedhë poshtë gjykata e revizionit, po që se një gjë të tillë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë brenda kufijve të autorizimeve të saja (neni 218 i këtij ligji).

Pranueshmëria e kërkesës

36. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

38. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

39. Përkitazi me përmbushjen e kritereve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: i. legjitimohet si palë e autorizuar, në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës; ii. ai konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Rev. nr. 434/2022] të 24 majit 2022 të Gjykatës Supreme dhe të Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit; iii. ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të paragrafit 2, të nenit 47 të Ligjit; iv. ka specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur nga gjykatat, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe v. kërkesën e ka dorëzuar brenda afatit ligjor prej katërt (4) muajve, siç përcakton neni 49 i Ligjit.
40. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me dispozitat (1) (d) dhe (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcaktojnë:
- (1) *“Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:
[...]
(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.*
- (2) *Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
[...]
41. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në nënrregullin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih, rastin [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih, gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
42. Gjykata gjithashtu konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç parashihet me paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, dhe për pasojë, kërkesa shpallet e pranueshme për shqyrtim në merita (shih, gjithashtu rastin e GjEDNj-së, [Alimuçaj kundër Shqipërisë](#), nr. 20134/05, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, paragrafi 144, si dhe shih rastet e Gjykatës [KI75/21](#), parashtrues “*Abrazen LLC*”, “*EnergyDevelopmentGroup Kosova LLC*”, “*Alsi&Co. Kosovë LLC*” dhe “*BuildingConstruction LLC*”, Aktgjykim i 19 janarit 2022, paragrafi 64; [KI27/20](#), parashtrues, *Lëvizja VETËVENDOSJE!*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 43, dhe së fundmi [KI82/22](#), parashtrues *Valon Loxhaj*, Aktgjykimi i 7 qershorit 2023, paragrafi 59).
43. Gjykata, sa më sipër, vlerëson se kërkesa e parashtruesve të kërkesës ngrenë pretendime serioze të nivelit kushtetues, andaj e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kritereve të përcaktuara në nënrregullin (2) të rregullit 34 të Rregullores së

punës. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i përmbush kushtet e pranueshmërisë për vlerësim në merita.

Meritat e kërkesës

44. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës, si pasojë e një aksidenti në komunikacion pësuan lëndime trupore, shkaktari i të cilit ishte i siguruari i të paditurës Sigal Uniqua Group Austria. Parashtruesit e kërkesës, ndaj kompanisë në fjalë, ushtruan kërkesëpadi në Gjykatën Themelore, nëpërmjet së cilës kërkuan kompensimin e dëmeve materiale dhe jomateriale për shkak të lëndimeve trupore dhe shpirtërore të pësuar. Kjo e fundit, kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e tyre dhe kishte detyruar të paditurën Sigal Uniqua Group Austria që t'ua paguaj atyre shumat e caktuara, sikurse janë reflektuar në pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 8751.00 euro. Parashtruesit e kërkesës por edhe e paditura Sigal Uniqua Group Austria, parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit, në të vërtetë kishte vendosur vetëm për ankesën e të paditurës Sigal Uniqua Group Austria, duke e refuzuar si të pabazuar të njëjtën. Me të pranuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit parashtruesit e kërkesës kuptuan se ankesa e tyre nuk ishte shqyrtuar fare nga kjo e fundit.
45. Për pasojë, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, ku përveç shkeljeve ligjore të njëjtit shprehimisht ngritën pretendime për shkelje të së drejtës për ankesë. Në ndërkohë edhe e paditura Sigal Uniqua Group Austria kishte parashtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, e cila me Aktgjykimin [Rev. nr. 426/2021] e 29 qershorit 2021, kishte refuzuar revizionin e saj. Me Aktgjykimin e 29 qershorit 2021 Gjykata Supreme nuk e kishte trajtuar revizionin e parashtruesve të kërkesës. Për pasojë, të njëjtit iu drejtuan sërish Gjykatës Supreme, duke kërkuar nga e njëjta që të merrte në shqyrtim revizionin e tyre, të ushtruar më 29 qershor 2020. Lidhur me këtë, Gjykata Supreme, më 24 maj 2022, nxori Aktvendim [Rev. nr. 434/2022], për plotësimin e Aktgjykimit [Rev. nr. 426/2021] të 29 qershorit 2021. Nëpërmjet aktvendimit plotësues, Gjykata Supreme e hedhë poshtë kërkesën për revizionin të parashtruesve të kërkesës, bazuar në nenet 221 dhe 162 të LPK-së, duke e mos e trajtuar fare pretendimin përkitazi me shkeljen e të drejtës në ankesë, gjegjësisht mjetin juridik të rregullt nga ana e Gjykatës së Apelit.
46. Në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata merr parasysh praktikën gjyqësore të GjEDNj-së dhe të saj, e cila përcakton se një ankesë/kërkesë karakterizohet nga faktet e përfshira në të, dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet në të cilat palët thirren shprehimisht (shih, rasti i GjEDNj-së: *Talpis kundër Italisë*, nr. 41237/14, Aktgjykimi i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e cituara aty).
47. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se esenca e pretendimeve për shkelje të të drejtave kushtetuese të parashtruesve të kërkesës ka të bëjë me: (i) mosshqyrtimin e ankesës së 31 gushtit 2017 nga ana e Gjykatës së Apelit, dhe me (ii) mosshqyrtimin në merita të kërkesës për revizion, nga ana e Gjykatës Supreme, nëpërmjet së cilës parashtruesit e kërkesës në mënyrë shprehimore pranë kësaj të fundit ngritën çështjen e mohimit të drejtësisë dhe të mjetit juridik nga Gjykata e Apelit.
48. Nga sa më lart, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, i ngritur në kërkesë nga parashtruesit e kërkesës ndërlihet kryesisht me (i) mohimin e të drejtës për “gjykim të drejtë”, përkatësisht me mohimin e të drejtës për “qasje në gjykatë/drejtësi” të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në ndërlihdje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së.

49. Andaj, Gjykata në vazhdim do t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës nga këndvështrimi i të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, duke aplikuar parimet përkatëse të përcaktuara, nëpërmjet praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në bazë të të cilave Gjykata në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitive për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e obliguar që: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.
50. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që drejtësia e procedurës vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih rastet e Gjykatës **KI62/17**, parashtruese: *Emine Simnica*, Aktgjykim i 29 majit 2018; paragrafi 41 dhe **KI20/21**, parashtruese: *Violeta Todorović*, Aktgjykim i 13 prillit 2021, paragrafi 38; shih, gjithashtu, Aktgjykimi i GjEDNj-së, **Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës**, nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 tetorit 1988, paragrafi 68). Prandaj, në procedurën e vlerësimit të bazueshmërisë së pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata do t'iu përmbahet këtyre parimeve.

I. Vlerësimi i Gjykatës, përkitazi me pretendimin për shkelje të së drejtës për “qasje në gjykatë/drejtësi”

a) Parimet e përgjithshme

51. E drejta për të pasur qasje në gjykatë për qëllime të nenit 6 të KEDNj-së është definuar në rastin **Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar**, nr. 4451/70, Aktgjykimi i 21 shkurtit 1975. Duke iu referuar parimit të sundimit të ligjit dhe shmangies së pushtetit arbitrar, GjEDNj-ja ka konstatuar se “e drejta për qasje në gjykatë” është aspekt thelbësor i garancive procedurale të mishëruara në nenin 6.1 të KEDNj-së. Sipas GjEDNj-së, kjo e drejtë i siguron çdokujt të drejtën e adresimit të çështjes përkatëse që ndërlidhet me “të drejta dhe detyrime civile”, para një gjykate (shih rastin e GjEDNj-së, **Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë**, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84).
52. Gjykata në këtë kontekst thekson se e “drejta në gjykatë”, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, përcakton që ndërgjyqësit duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih, rastet e GjEDNj-së, **Bëleş dhe të tjerët kundër Republikës Çeke**, nr. 47273/ 99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 49; dhe **Nait-Liman kundër Zvicrës**, 513557/07, Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 112).
53. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, çdokush ka të drejtë që të paraqesë “padi” lidhur me të “drejtat dhe detyrimet civile” përkatëse, në një gjykatë. Neni 31 i Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së mishërojnë të “drejtën për gjykatë” përkatësisht “të drejtën e qasjes në gjykata”, e që nënkupton të drejtën për të filluar procedurat tek gjykatat në çështjet civile (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNj-së, **Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar**, cituar më lart, paragrafi 36).
54. Sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, së pari duhet të ekzistojë një “e drejtë civile” dhe së dyti, duhet të ketë një “kontest” lidhur me ligjshmërinë e një ndërhyrje, që prekë vetë ekzistencën apo fushëveprimin e “të drejtës civile” të mbrojtur. Dëfinimi i këtyre dy koncepteve duhet të jetë përmbajtjesor dhe joformal (shih, në këtë aspekt, rastet e GjEDNj-së, **Le Compte, Van Leuven and De Meyere kundër Belgjikës**, nr. nr. 6878/75, 7238/75, Aktgjykim i 23 qershorit 1981, paragrafi 45; **Moreira de Azevedo kundër Portugalisë**, nr. 12686/03, Aktgjykim i 23 tetorit 1990, paragrafi 66; **Boulois kundër Luksemburgut** nr. 37575/04, Aktgjykim i 20 marsit 2009, paragrafi 29; dhe **Boulois**

kundër Luksemburgut, nr. 37575/04, Aktgjykim i 3 prillit 2012, paragrafi 92). Neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, garantojnë jo vetëm të drejtën për të filluar procedura, por edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje të “kontestit” përkatës nga një gjykatë (shih, rastet e GjEDNj-së, *Kutić kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, Aktgjykim i 1 marsit 2002, paragrafët 25-32; *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 86 dhe referencat në të; *Acimović kundër Kroacisë*, nr. 61237/00, Aktgjykim i 9 tetorit 2003, paragrafi 41; dhe *Beneficio Cappella Paolini kundër San Marinos*, nr. 40786/98, Aktgjykim i 13 korrikut 2004, paragrafi 29).

55. Megjithatë, parimet e lartpërmendura nuk nënkuptojnë që e drejta për gjykatë dhe e drejta e qasjes në gjykatë janë të drejta absolute. Ato mund të jenë subjekt i kufizimeve, të cilat janë qartë të përcaktuara nga praktika gjyqësore e GjEDNj-së. Këto kufizime nuk mund të shkojnë deri në atë masë sa të kufizojnë qasjen e individit, duke cenuar vetë thelbin e të drejtës (shih GjEDNj, *Baka kundër Hungarisë*, nr. 20261/12, Aktgjykim i 23 qershorit 2016, paragrafi 120; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 89). Kurdo që qasja në gjykatë kufizohet nga ligji ose praktika përkatëse gjyqësore, Gjykata shqyrton nëse kufizimi i tillë prekë thelbin e të drejtës dhe, në veçanti, nëse ky kufizim ka ndjekur një “qëllim legjitim”, si dhe nëse ekziston “një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet” (shih, rastet e GjEDNj-së, *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8225/78, Aktgjykim i 28 majit 1985, paragrafi 57; *Nait-Liman kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 21 shtatorit 1990, paragrafi 65; dhe *Marković dhe të tjerët kundër Italisë*, nr. 1398/03, Aktgjykim i 14 dhjetorit 2006, paragrafi 99). E drejta për qasje në gjykatë mund t’i nënshtrohet në rrethana të caktuara, disa kufizimeve legjitime, të tilla si afatet ligjore të parashkrimit, urdhrave që kërkojnë pagesën e një garancie, një kërkesë përfaqësimi (rastet e GjEDNj-së, *Stubbings dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 22095/93, Aktgjykim i 22 tetorit 1996; *Tolstoy Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 18139/91, Aktgjykim i 13 korrikut 1995; *R.P dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 38245/08, Aktgjykim i 9 tetorit 2012).

56. Të gjitha këto parime të përcaktuara nga GjEDNj-ja përkitazi me të drejtën për “qasje në gjykatë/drejtësi”, janë përdorur dhe etabluar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, në zgjidhjen e rasteve konkrete kur palët kanë pretenduar mohimin e të drejtës për “qasje në drejtësi” (shih rastet, në të cilat Gjykata ka konstatuar shkelje të së drejtës për qasje në drejtësi, **KI10/22**, parashtrues *Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022; **KI224/19**, parashtrues *Islam Krasniqi*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020; **KI143/21**, parashtrues *Avdyl Bajgora*, Aktgjykim i 25 nëntorit 2021; **KI80/19**, parashtrues *Radomir Dimitrijević*, Aktgjykim i 10 nëntorit 2020; **KI214/21**, parashtrues *Avni Kastrati*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2022, dhe rastet në të cilat nuk është konstatuar shkelje e së drejtës për “qasje në drejtësi”, **KI133/17**, parashtrues *Ali Gashi*, Aktvendim i 29 korrikut 2019; **KI62/18**, parashtrues *Nadlije Gojani*, Aktvendimi i 27 shtatorit 2018, **KI78/18**, parashtrues *Pashk Malota*, Aktvendimi i 27 shkurtit 2019, **KI92/21**, parashtrues *Fadil Ponosheci*, Aktvendim i 21 tetorit 2021.

b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

57. Gjykata bazuar në shkresat e lëndës rikujton se esenca e shkeljes së të drejtës për të pasur “qasje në gjykatë/drejtësi” si rrjedhojë edhe për mjet efektiv juridik dhe mbrojtje efektive gjyqësore, ka të bëjë me (i) mosshqyrtimin e ankesës së parashtruesve të kërkesës nga ana e Gjykatës së Apelit, të dorëzuar më 31 gusht 2017 nëpërmjet Gjykatës Themelore, dhe (ii) mosshqyrtimin e kërkesës për revizion në merita nga ana e Gjykatës

Supreme, i cili ndërli dhej me shkeljen e të drejtës për ankesë, gjegjësisht mjet juridik, si rezultat i mosshqyrtimit të ankesës së 31 gushtit 2017 nga ana e Gjykatës së Apelit.

58. Gjykata, në kontest të thelbit të pretendimeve fillimisht rikujton se, “çdokush që konsideron se ka pasur ndërhyrje të kundërligjshme në ushtrimin e të drejtave civile të tij/saj dhe pretendon se i është kufizuar mundësia për të kontestuar një pretendim specifik para një gjykate, mund t’i referohet nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, duke u thirrur në të drejtën për “qasje në drejtësi” (shih, rastin e GjEDNj-së, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 36).
59. Bazuar në parimet e lartpërmendura, Gjykata thekson se e drejta për qasje në gjykatë/drejtësi, në parim, është e garantuar përkitazi me “kontestet” në lidhje me një “të drejtë civile”. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se për të përcaktuar aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, duhet pasur parasysh se kemi të bëjmë me dy çështje esenciale. E para ndërli dhe me “të drejtën civile”, ndërsa e dyta me ekzistencën e një “kontesti” mosmarrëveshjeje reale e cila kërkon zgjidhje në rrugë gjyqësore.
60. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar të dy kriteret e lartcekura, për faktin se kemi një “kontest” real mes tyre dhe të paditurës Sigal Uniqua Group Austria, ku ndaj kësaj të fundit parashtruesit e kërkesës ushtruan kërkesëpadi, nëpërmjet së cilës kërkuan dëmshpërblim monetar, kërkesa të cilat sipas ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve hyjnë në të “drejtat civile” për shkak të natyrës së kontestit.
61. Meqë janë përmbushur kriteret e mësipërme, Gjykata në vazhdim do të analizojë nëse mohimi i kësaj të drejte themelore që u garantohet individëve me nenin 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së gjykatave të rregullta.
- i. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, nga ana e Gjykatës së Apelit*
62. Në kontekst të argumentimit të pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata e Apelit, nuk e kishte trajtuar fare ankesën e tyre të parashtruar pranë kësaj të fundit, më 31 gusht 2017, kundër Aktgjykimit [C. nr. 395/15] të 23 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore, duke theksuar se pretendimet e tyre kanë ngelur pa u adresuar në themel.
63. Në këtë drejtim, Gjykata iu referua shkresave të lëndës dhe vërejti si qëndron fakti se parashtruesit e kërkesës, kundër Aktgjykimit [C. nr. 395/15] të 23 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore, më 31 gusht 2017 kishin parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet Gjykatës Themelore. Megjithatë kjo e fundit, më 4 mars 2020 nëpërmjet Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018], kishte vendosur vetëm për ankesën e të paditurës Sigal Uniqua Group Austria, por jo edhe për ankesën e parashtruesve të kërkesës (padiësve), nëpërmjet së cilës të njëjtit kishin ngritur pretendime për shkelje të të drejtave të tyre nga ana e Gjykatës Themelore.
64. Më këtë rast, Gjykata e Apelit duke pasur parasysh faktin që parashtruesit e kërkesës ishin palë paditëse në këtë çështje, ia kishte percjellur atyre Aktgjykimin [Ac. nr. 1148/2018] e 4 marsit 2020. Nga ky moment, parashtruesit e kërkesës kuptuan se ankesa e tyre e parashtruar më 31 gusht 2017, kundër Aktgjykimit [C. nr. 395/15] të 23 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore, nuk ishte trajtuar fare nga Gjykata e Apelit, sikundër edhe pretendimet e tyre për akordimin e shumës së ulët të dëmeve materiale

dhe jomateriale mbeten pa u adresuar meritorisht nga kjo e fundit. Referuar përmbajtjes së aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, Gjykata vëren se në tekstin e Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit nuk përmendet fare, si fakt, se parashtruesit e kërkesës, kundër Aktgjykimit [C. nr. 395/15] të 23 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore, kishin parashtruar ankesë më 31 gusht 2017.

65. E ndodhur para rrethanave të këtylla, Gjykata Kushtetuese më 26 korrik 2023 nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, kërkoi informata shtesë për të kuptuar arsyet e mostrajtimin të ankesës së parashtruesve të kërkesës. Në lidhje me këtë, më 28 korrik 2023, Gjykata e Apelit informoi Gjykatën se *“në shkresat e lëndës të cilat mbesin në këtë gjykatë nuk ka pasur ankesa tjera, dhe se për informata shtesë, nëse ka pasur ankesa të tjera, Gjykata duhet t'i drejtohet Gjykatës Themelore në Ferizaj”*.
66. Në ndërkohë, më 3 gusht 2023, Gjykata Themelore në Ferizaj, në përgjigjen e saj dërguar Gjykatës, theksoi: *“... se mjeti juridik - ankesa e palëve paditëse Mexhid Asllani, Ekrem Asllani dhe Nuredin Xhaferi është dorëzuar dhe protokolluar në Gjykatën Themelore Ferizaj, me datë 5 shtator 2017”*, duke i bashkëngjitur përgjigjes një kopje të ankesës së parashtruar nga parashtruesit e kërkesës më 31 gusht 2017, e cila në këtë gjykatë ishte protokolluar më 5 shtator 2017. Meqë nga përgjigjja e Gjykatës Themelore, nuk kuptohej nëse ankesa e parashtruesve të kërkesës ishte proceduar për trajtim në Gjykatën e Apelit, Gjykata më 8 shtator 2023 nga Gjykata Themelore sërish kërkoi sqarime shtesë dhe kjo e fundit më 25 shtator 2023 informoi Gjykatën se, edhe ankesa e parashtruesve të kërkesës edhe ajo e të paditurës Sigal Uniqua Group Austira, pasi që ishte kompletuar lënda (dosja) dhe ishin plotësuar kushtet për procedim, lënda i është dorëzuar Gjykatës së Apelit për trajtim të mëtutjeshëm.
67. Sa më sipër, Gjykata rikujton se edhe parashtruesit e kërkesës por edhe paditura Sigal Uniqua Group Austria, paralelisht apeluan Aktgjykimin [C. nr. 395/15] e 23 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore, në Gjykatën e Apelit. E paditura për shkak të (i) shumës së lartë të akorduar, ndërsa parashtruesit e kërkesës për shkak të (i) shumës së ulët të akorduar në raport me dëmet e pësuar nga aksidenti. Megjithatë, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [Ac. nr. 1148/2018] e 4 marsit 2020, kishte vendosur vetëm për ankesën e të paditurës Sigal Uniqua Group Austria, por jo edhe për ankesën e 31 gushtit 2017 të parashtruesve të kërkesës. Në këtë kontekst është i pakontestueshëm fakti se Gjykata e Apelit me aktgjykimin e 4 marsit 2020 ka trajtuar vetëm pretendimet e të paditurës Sigal Uniqua Group Austria dhe kësaj ankesa e parashtruesve të kërkesës, por edhe pretendimet e ngritura në ankesë kanë ngelur pa u adresuar në themel nga kjo instancë gjyqësore.
68. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës në aspektin përmbajtësor (substancial) është shqyrtuar vetëm nga një instancë gjyqësore, përkatësisht vetëm nga Gjykata Themelore në Ferizaj, dhe nga asnjë instance tjetër gjyqësore, përfshirë këtu edhe Gjykatën Supreme, pranë së cilës parashtruesit e kërkesës në mënyrë shprehimore kanë ngritur shkeljen e të drejtës së tyre për mohim të drejtësisë dhe të mjetit të rregullt juridik (ankesës) nga ana e Gjykatës së Apelit.
69. Marrë parasysh faktin se parashtruesit e kërkesës më 31 gusht 2017 kanë ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, dhe kjo e fundit nuk e ka trajtuar fare atë, as me Aktgjykimin [Ac. nr. 1148/2018] e 4 marsit 2020 dhe as veçmas, Gjykata konsideron se parashtruesve të kërkesës u është pamundësuar shqyrtimi i thelbit të pretendimeve të ngritura nëpërmjet ankesës së tyre, kundër Aktgjykimit [C. nr. 395/15] të 23 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore.
70. Gjykata përsëritë se nuk është detyrë e saj të vlerësojë nëse gjykatat e rregullta kanë interpretuar dhe zbatuar drejtë rregullat përkatëse të së drejtës materiale dhe

procedurale. Megjithatë, në rastet kur një pretendim ngrenë çështje kushtetuese, përkatësisht parregullsi të procesit gjyqësor, Gjykata është e detyruar të ndërhyjë dhe të riparojë shkeljet e shkaktuara nga gjykatat e rregullta, për t'i siguruar individit një gjykim të drejtë në pajtueshmëri me nenin 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së. (shih, rastin e Gjykatës KI214/22, parashtrues *Avni Kastrati*, Aktgjykimi 7 dhjetorit 2022, paragrafi 127).

71. Duke iu referuar rrethanave të rastit konkret, Gjykata konstaton se mosshqyrtimi i ankesës së parashtruesve të kërkesës në merita nga ana e Gjykatës së Apelit, përbën një të metë procedurale të pakapërcyeshme e cila është në kundërshtim me të drejtën për qasje në drejtësi. Thënë këtë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Apelit ua ka mohuar parashtruesve të kërkesës të drejtën për qasje në gjykatë/drejtësi të garantuar me paragrafin 1, të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së.

ii. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, nga ana e Gjykatës Supreme

72. Përveç pretendimeve për mohimin e drejtësisë dhe të mjetit juridik nga ana e Gjykatës së Apelit, parashtruesit e kërkesës të njëjtat pretendime i kanë ngritur edhe në Gjykatën Supreme. Në këtë kontest, referuar shkresave të lëndës, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës, pasi e kanë pranuar Aktgjykimin [Ac. nr. 1148/2018] e 4 marsit 2020, të Gjykatës së Apelit, me të cilin ishte vendosur për ankesën e të paditurës Sigal Uniqua Group Austria, por jo edhe për ankesën e tyre, i janë drejtuar Gjykatës Supreme me kërkesë për revizion, të bindur se kërkesa e tyre do të trajtohej meritorisht, duke pasur parasysh natyrën e shkeljes së shkaktuar nga Gjykata e Apelit. Në kërkesën e tyre për revizion të 29 qershorit 2020 dhe atë të përsëritur më 2 gusht 2021, parashtruesit e kërkesës në mënyrë specifike ngritën shkeljen e të drejtës në ankesë, e cila për pasojë ka rezultuar me mosshqyrtimin e thelbit të pretendimeve të tyre, të ngritura kundër Aktgjykimin të Gjykatës Themelore.
73. Gjykata vlerëson se rasti konkret është specifik për nga rrethanat faktike dhe juridike, prandaj dhe duhet trajtuar, si i tillë nga ana e Gjykatës, kur bëhet fjalë për vlerësimin e kriterëve të pranueshmërisë. Në rastin para nesh kemi të bëjmë me një kërkesëpadi të ngritur nga disa parashtrues (bashkëpaditës), kundër një të paditure, për shkak të dëmeve materiale dhe jomateriale të shkaktuara nga i siguruari i saj, ku përmbajtja e normës së ligjit dallon në varësi të specifikave që ngërthen vetë rasti, për sa i përket përmbushjes së kushteve ligjore për të paraqitur kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme. Rrethanat e rastit konkret flasin për një të metë procedurale, e cila është shkaktuar thjeshtë nga neglizhenca e gjykatës së shkallës së dytë, e cila ka rezultuar në cenimin e të drejtës për qasje në gjykatë/drejtësi të parashtruesve të kërkesës, e cila kërkon zgjidhjen e çështjes në themel.
74. Andaj, duke pasur parasysh natyrën e shkeljes që ka ndodhur përgjatë gjykimin të këtij rasti, Gjykata konsideron se do të ishte paragjykuese nga ana e saj, po të vlerësonte se pranë Gjykatës Supreme, parashtruesit e kërkesës nuk kanë pasur në dispozicion të tyre një mjet efektiv për të përdorur për shkeljet e shkaktuara nga ana e Gjykatës së Apelit në këtë rast. Kjo marrë parasysh natyrën e shkeljes kushtetuese e cila ka ndodhur në Gjykatën e Apelit, siç është e drejta për të apeluar vendimet e gjykatës së shkallës së parë pranë kësaj të fundit. Mbi këto baza, parashtruesit e kërkesës kanë besuar në efektivitetin e mjetit të përdoruar (revizionit) dhe në riparimin e shkeljes së shkaktuar nga Gjykata e Apelit. Për më tepër, Gjykata rikujton se edhe në rastet kur palët kanë mëdyshje rreth efektivitetit të mjetit juridik, praktika gjyqësore e GjEDNj-së, përcakton që: *“në rastet kur parashtruesit e kërkesës kanë mëdyshje për efektivitetin e mjetit juridik, ai duhet të përdoret dhe se për përdorimin e tij nuk mund të mbahet përgjegjës*

79. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se nga Gjykata e Apelit nuk mund të pritej që të akordonte dëmshpërblim më të madh për parashtruesit e kërkesës, ngase para saj objekt i kontestuar me ankesë nga ana e të paditurës Sigal Uniqua Group Austria, ishte shuma e lartë e dëmshpërblimit e caktuar nga gjykata e shkallës së parë për parashtruesit e kërkesës, të cilën shumë detyrohej ta paguante e paditura. Prandaj, duke pasur parasysh këto rrethana, Gjykata Supreme do të duhej fokusuar në thelbin e shkëljes së pretenduar nga parashtruesit e kërkesës, që ishte e drejta në ankesë (mjet juridik) dhe jo të pranonte si të mirëqenë Aktgjykimin [Ac. nr. 1148/2018] e 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit, me të cilin nuk u vendos për të drejtat dhe detyrimet civile të parashtruesve të kërkesës, por për ato të të paditurës. Të mjaftuarit e Gjykatës Supreme për të vendosur për revizionin e parashtruesve të kërkesës, vetëm mbi bazën e asaj se çfarë kishte vendosur Gjykata e Apelit, sipas ankesës së të paditurës Sigal Uniqua Group Austria, me Aktgjykimin [Ac. nr. 1148/2018] e 4 marsit 2020, ka bërë që të prejudikohet rezultati i meritave të çështjes, që potencialisht do të mund të dilte nga marrja në shqyrtim e ankesës së parashtruesve të kërkesës, për të cilën nuk është vendosur asnjëherë nga Gjykata e Apelit.
80. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës në Gjykatën Supreme shprehimisht e ngritën shkëljen e të drejtës në ankesë. Megjithatë edhe përkundër këtij fakti Gjykata Supreme, nuk e kishte trajtuar fare pretendimin thelbësor të tyre. Gjykata, duke u bazuar në rrethanat specifike, faktike dhe juridike të rastit konkret, rikujton se në bazë të paragrafit 3 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, qartazi dhe shprehimisht parashihet që: *“3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit, që nënkupton se gjykatat e rregullta, kur interpretojnë dhe zbatojnë norma ligjore përkatëse, duhet të kujdesen që të mos shkelin vetë thelbin e të drejtës së garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ. Për më tepër, gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme, si instancë përfundimtare e gjyqësorit të rregullt, janë të obliguara nga neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës, që: “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
81. Sa më lart, Gjykata vlerëson se neglizhenca për t’i trajtuar në mënyrën e duhur parashtruesit e parashtruesve të kërkesës dhe pretendimet e ngritura në to, në rrethanat e rastit konkret, rendon mbi gjykatat e rregullta të cilat janë të thirrura për të ofruar drejtësi. Parashtruesit e kërkesës kanë bërë gjithçka çka u është kërkuar nga ligji për të ushtruar të drejtën e tyre në ankesë (mjet juridik) në mënyrë efektive pranë gjykatave të rregullta dhe kjo qartazi vërtetohet me faktin e protokollimit të ankesës së tyre në Gjykatën Themelore, më 5 shtator 2017 dhe të procedimit të ankesës së tyre për shqyrtim në Gjykatën e Apelit. Nuk mund t’u kërkohej parashtruesve të kërkesave që të shndërrohen në kujdestarë të ecurisë së procesit, duke e ndjekur ecurinë e çështjes, se ku kanë përfunduar parashtruesit e tyre, dhe nëse kanë mbërritur në vendin e duhur apo jo, përderisa ankesa e tyre është dorëzuar në mënyrë të rregullt në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet Gjykatës Themelore.
82. Gjykata, në rastin konkret, konsideron se pamundësia për të adresuar pretendimet specifike të ngritura nga parashtruesit e kërkesës nëpërmjet ankesës së parashtruar më 31 korrik 2017 në Gjykatën e Apelit, dhe mosriparimi i shkëljes së të drejtës në ankesë nga ana e Gjykatës Supreme, përbën një të metë procedurale, e cila si rrjedhojë ka cenuar vetë thelbin e të drejtës së parashtruesve të kërkesës për të marrë një përgjigje meritore dhe të arsyetuar për çështjen e tyre. (Shih, rastin e GjEDNJ-së, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 36, dhe rastin e Gjykatës, [KI214/22](#), me parashtrues, *Avni Kastrati*, Aktgjykimin i 7 dhjetorit 2022, paragrafi 128, dhe rastet e cituara aty).

83. Thënë këtë, Gjykata konstaton se mosshqyrtimi i ankesës, si rrjedhojë dhe i pretendimeve të ngritura në të nga ana e parashtruesve të kërkesës në Gjykatën e Apelit, dhe mostrajtimi i pretendimit thelbësor nga Gjykata Supreme, në lidhje me mohimin e të drejtës së ankesës nga Gjykata e Apelit, ka cenuar të drejtën e tyre për “qasje në drejtësi”, si rrjedhojë edhe të drejtën për mjet efektiv juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave pranë këtyre instancave gjyqësore.

Përfundime

84. Gjykata bazuar në analizën e mësipërme, konkludon se Aktvendimi [Rev. nr. 434/2022] i 24 majit 2022, për plotësimin e Aktgjykimit [Rev. nr. 426/2021] të 29 qershorit 2021 të Gjykatës Supreme, dhe Aktgjykimi [Ac. nr. 1148/2018] i 4 marsit 2020 i Gjykatës së Apelit janë nxjerrë në shkelje të të drejtave kushtetuese të parashtruesve të kërkesës, të garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNj-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 dhe 47 të Ligjit, si dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, më 21 mars 2024:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, me pesë (5) vota për dhe katër (4) kundër, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me pesë (5) vota për dhe katër (4) kundër, se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TË SHPALLË, me pesë (5) vota për dhe katër (4) kundër, të pavlefshëm Aktvendimin e 24 majit 2022 [Rev. nr. 434/2022], dhe Aktgjykimin e 29 qershorit 2021 [Rev. nr. 426/2021] të Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimin e 4 marsit 2020 [Ac. nr. 1148/2018] të Gjykatës së Apelit;
- IV. TË KTHEJË, me pesë (5) vota për dhe katër (4) kundër, Aktgjykimin [Ac. nr. 1148/2018] e 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit, në rivendosje pranë kësaj të fundit, në pajtim me konstatimet e Gjykatës, në këtë Aktgjykim;
- V. TË URDHËROJË Gjykatën e Apelit, që të njoftojë Gjykatën, në pajtim me nënrrregullin (5) të rregullit 60 të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës, jo më larg se më 23 shtator 2024;
- VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VII. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 2 të Ligjit;
- VIII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani